



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 641/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.10.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Kundërshtimi i vendimit të KVO-së në lidhje me vlerësimin me pikë të propozimit teknik të BOE “Instituti i Konulencës në Ndërtim IKN” shpk & “Geosat Group” shpk në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues:

BOE “Instituti Konsulencës në Ndërtim IKN” shpk & “Geosat Group” shpk
Rruga “Eduart Mano”, P.20, K.0 Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Autoriteti Rrugor Shqiptar
“Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.05.2019, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor depozituar pranë KPP më shkresën nr.1430/2 datë 02.09.2019 rezulton se në datën 05.06.2019 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (shprehja e interesit), ku rezulton se kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë:

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*
- *Taulant*
- *A&E Engineering*
- *Archnet 360*
- *Nord –Comat*
- *Klodioda*
- *C.E.C Group*
- *Gjeokonsult&Co*
- *Infra Plan*
- *Toëer*

II.3. Në datën 14.06.2019 është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, nga ku rezulton se në këtë fazë janë kualifikuar operatorët ekonomikë si më poshtë:

Të kualifikuar

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*
- *Taulant*
- *A&E Engineering*
- *Nord –Comat*
- *Klodioda*
- *Gjeokonsult&Co*
- *Infra Plan*

Të skualifikuar

- *Archnet 360*
- *C.E.C Group*
- *Toëer*

II.4. Në datën 12.07.2019 është zhvilluar faza e dytë e procedurës së prokurimit për dorëzimin e propozime teknike dhe ekonomike.

Operatorët pjesmarrës ishin si më poshtë:

- *Instituti i Konsulencës në Ndërtim “IKN”*

- Taulant
- A&E Engineering
- Nord –Comat
- Klodioda
- Gjeokonsult&Co
- Infra Plan

II.5. Në datën 31.07.219 KVO-ja përfundoi vlerësimin e propozimeve teknike të ofertuesve të kualifikuar si më poshtë:

1. Për operatorin ekonomik A&E Engineering

Anëtari i KVO	Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë	Metodologjia e propozuar 20-30 pikë	Kulaiifkimet e stafit kryesor të propozuar 20-50	Transferimi i njourive nëse kërkohet	Total
1	9	22	30+10		71
2	9	22	30+10		71
3	9	23	30+10		72

Pikë mesatare 71.333 pikë

2. Për operatorin ekonomik Taulant

Anëtari i KVO	Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë	Metodologjia e propozuar 20-30 pikë	Kulaiifkimet e stafit kryesor të propozuar 20-50	Transferimi i njourive nëse kërkohet	Total
1	9	22	31+10		72
2	9	21	31+10		71
3	9	23	31+10		72

Pikë mesatare 71.666 pikë.

3. Për operatorin ekonomik Klodioda

Anëtari i	Përvoja punë	Metodologjia	Kulaiifkimet	Transferimi i	Total
-----------	--------------	--------------	--------------	---------------	-------

<i>KVO</i>	<i>të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>njourive nëse kërkohet</i>	
1	7	23	31+10		71
2	7	24	32+10		73
3	7	23	31+10		71

Pikë mesatare 71.666 pikë

4. Për operatorin “ Geosat Group”&Instituti i Konsulencës në Ndërtim

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kulafikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
1	9	25	30+10		74
2	9	26	30+10		75
3	9	25	30+10		74

Pikë mesatare 74.333 pikë

5. Për operatorin ekonomik Gjeokonsult&Co shpk

<i>Anëtari i KVO</i>	<i>Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë</i>	<i>Metodologjia e propozuar 20-30 pikë</i>	<i>Kulafikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50</i>	<i>Transferimi i njourive nëse kërkohet</i>	<i>Total</i>
1	10	30	45+10		95
2	10	29	44+10		93
3	10	30	47+10		97

Pikë mesatare 95 pikë

6. Për operatorin ekonomik Infra-Plan&PNI-2001

Anëtari i KVO	Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë	Metodologjia e propozuar 20-30 pikë	Kulaiifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50	Transferimi i njourive nëse kërkohet	Total
1	8	23	35+10		76
2	8	22	35+10		75
3	8	24	35+10		77

Pikë mesatare 76 pikë

7. Për operatorin ekonomik Nord –Comat

Anëtari i KVO	Përvoja punë të ngjashme 0-10 pikë	Metodologjia e propozuar 20-30 pikë	Kulaiifikimet e stafit kryesor të propozuar 20-50	Transferimi i njourive nëse kërkohet	Total
1	8	20	32+10		70
2	8	20	32+10		70
3	8	20	32+10		71

Pikë mesatare 70.333 pikë

II.6. Në datën 07.08.2019, BOE “Geosat Group”& “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vlerësimin në pikë të propozimit të tij teknik duke pretenduar si më poshtë:

- Nisur nga kriteret e vlerësimit të propozimit teknik për zërin Përvoja në punë të ngjashme të Konsulentit BOE “Geosat Group”& “Instituti i Konsulencës në Ndërtim” shpik ka paraqitur si përvoja në punë të ngjashme kontaktat sipas tabelës së mëposhtme dhe duke pasur një vlerë totale të punimeve të ngjashme prej 16,143,654 lekë pa tvsh. Kjo vlerë e kalon disa herë kërkesën e DST ku përvoja e mëparshme në punë të ngjashme duhej në një vlerë jo më të vogël se 38 % e fondit limit. Duke qenë se e përmbushim dhe e tejkalojmë 4 herë kërkesën e DST për përvojë të mëparshme në punë të ngjashme si dhe gjithashtu plotësojmë kërkesat e kapacitetit ekonomik dhe certifikatat e standarteve të cilësisë ISO kërkojmë të dimë se pse nga 10 pikë të mundshme jemi vlerësuar me 9 pikë dhe pse konkurenti ynë Gjeokonsult&CO ka marrë pikët maksimale.

<i>N r</i>	<i>Kontrata</i>	<i>Subjekt i</i>	<i>Viti i përfundim it</i>	<i>Investito ri</i>	<i>Pjesma rrja në përqin dje</i>	<i>Vlera e kontratës pa tvsh</i>	<i>Vlera pa tvsh</i>
1	<i>Ndërtim i infrastrukturës rrugore në kompleksin Hamallaj</i>	<i>IKN</i>	<i>Prill 2018</i>	<i>Mane TCI</i>	<i>100%</i>	<i>2,880,000</i>	<i>2,880,000</i>
2	<i>Mbrojtja dhe sistemi i pjesës së poshtme të digës së Qyrsaqit</i>	<i>IKN</i>	<i>Gusht 2018</i>	<i>KESH</i>	<i>70 %</i>	<i>3,172,432</i>	<i>2,220,702</i>
3	<i>Rikualifikim i shatërvanit tek Zogu Zi</i>	<i>IKN</i>	<i>Tetor 2018</i>	<i>Fushë Krujë Cement Factory /përfitues Bashkia Tiranë</i>	<i>100%</i>	<i>2,307,060</i>	<i>2,307,060</i>
4	<i>Ndërtim Rrugor Porto Romano Loti I</i>	<i>Geosat</i>	<i>Shtator 2017</i>	<i>ARRSH</i>	<i>100%</i>	<i>4,900,452</i>	<i>4,900,452</i>
5	<i>Supervizim i rikonstruksion it të rrugës rrethrrrotullim i i doganës – mbikalimi kashar dhe rikonstruksion i i rrugës hyrëse të Elabasanit segmenti Fakulteti Filologjik Unaza e</i>	<i>Geosat</i>	<i>Shtator 2015</i>	<i>FSHZH</i>	<i>80%</i>	<i>2,900,000</i>	<i>2,320,000</i>

	<i>Madhe</i>						
6	<i>Rikualifikimi Urban i Sheshit Skënderbej</i>	<i>Geosat</i>	<i>Nëntor 2017</i>	<i>Bashkia Tiranë</i>	<i>40%</i>	<i>3,788,600</i>	<i>1,515,440</i>
<i>Totali i BOE Lekë pa tvsh 16,143,654</i>							

- *Vlerësimi për Metodologjinë e propozuar gjithashtu është i padrejtë Metodologjia e propozuar nga BOE IKN&Geosat është shumë e kompletuar dhe e detajuar duke paraqitur problemet kryesore , rëndësinë e tyre si dhe ka shpjeguar përjasjen teknike që do adaptohet për zgjidhjen e tyre.*

Metodologjia e propozuar nga ne përmban informacion të zgjeruar mbi historikun e segmentit pallati me shigjeta-rrethrotullimi Shqiponja , informacion mbi Lotin 2 km (0+760÷1+600), Punimet ndërtimore Nyja 2 (Ura në Lanë) (km 0+740÷0+900); Punime ndërtimore Nyja 3 (Nënkalimi 4) (km 1+500-1+600), Punime ndërtimore Trup rrugë+rrugë urbane (km 0+900÷1+500); Punime për ndërtimin e ndricimit rrugor; Sistemi i kullimit të Ujrave Atmosferike si dhe Sinjalistika rrugore, siguria dhe siguria në punë.

Në mënyrë të detajuar janë përshkruar detyrat dhe përgjegjësitë e mbikqyrësit duke përcaktuar saktë dhe shumë qartë stafin e projektit , funksionet dhe detyrat e secilit prej tyre si dhe stafit mbështetës që bashkimi ynë i operatorëve vë në dispozicion të realizmit me sukses të këtij projekti.

Më pas vazhdohet me metodologjinë e mbikqyrjes , aktivitet paraprake, fazën e mobilizimit, veprimtaria dokumentare dhe teknike, miratimi për kontraktorin, siguria në punë , deklaratat e qëllimit të kontraktorit. Vazhdohet me fazat e zbatimit dhe planin e kontrollit, testimet dhe monitorimin e punës për germimet, mbushje e trupit të rrugës, nënbaza dhe baza e rrugës, shtresat asfaltike, trotualet , veprat e artit, strukturat B/arme, punimet e kanalizimeve, punimet elektrike, ndricimi, sinjalistika rrugore. Po kështu në mënyrë të qartë përcaktohen takimet javore dhe mujore të rëndësishme këto për një mbarvajtje të mirë të punës.

Raportimi tek investitori në mënyrë të herpashershme dhe në mënyrë periodike zë një vend të rëndësishëm në Metodologji duke përcaktuar dhe përmbajtjen e raportit mujor duke u kujdesur që ky raport të jetë i plotë dhe gjithëpërfshirës përsa i përket stafit të angazhuar nga Mbikqyrësi , raportimit mbi aktivitetet e realizuara në objekt për ndjekjen dhe kontrollin e punimeve, grafikut të shërbimit të mbikqyrjes , përshkrimit të detajuar të projekt zbatimit, organizimit të kontraktorit, progresit mujor, grafikut të ecurisë së punimeve, statusi financiar, volumeve të punimeve mujore, korenspondencave, problemeve gjatë zbatimit dhe konkluzioneve të raportit.

Metodologjia e propozuar përshkruan mënyrën e kontrollimit të kostove të projektit si dhe një rëndësi dhe vëmendje të vecantë i kushtohet mbrojtjes së mjedisit duke përgatitur një plan të kontrollit të mjedisit gjatë fazës së mobilizimit dhe kërkesës që

ky plan të zbatohet nga kontraktori gjatë ndërtimit të objektit. Pas konfirmimit të përfundimit të punimeve për projektin me shkrim nga kontraktori do të kryhen testet e komisioneve për të siguruar që performanca e pajisjeve të instaluar, sistemeve të instaluar të jetë e kënaqshme duke plotësuar kërkesat në projekt dhe specifikimet. Dokumentacioni i marrjes në dorëzim nga ana e mbikqyrësit duhet të plotësohet konform dispozitave ligjore dhe jo vetëm si dhe jepet lista e dokumentave që duhen plotësuar dhe pasi ky dokumentacion grumbullohet e dokumentohet mbikqyrsi e paraqet pranë investitorit.

BOE IKN & Geosat shpk ka paraqitur në mënyrë shumë të qartë dhe të saktë grafikun e punimeve sipas fazave të punës dhe dorëzimit të projektit si dhe grafiku i organizmit të stafit kryesor. Këtu janë propozuar aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit duke transformuar kërkesat e termave të referencës në një plan pune konkret.

Në metodologji është përfshirë një numër i madh vizatimesh, grafikesh dhe tabelash të cilat e kanë kompletuar dhe qartësuar metodologjinë e propozuar.

Gjithashtu në mënyrë shumë të saktë është paraqitur edhe mënyra e kompozimit dhe struktura e stafit kryesor, lista e ekspertëve kryesorë, stafi mbështetës që është i shumtë në numër, me përvojë shumvjeçare në mbikqyrje si dhe personeli ekonomik administrativ. Është paraqitur CV e të dy kompanive të BOE ku tregohet eksperiencë shumëvjeçare në mbikqyrje, konsulence e projektim.

Kjo metodologji meriton vlerësimin maksimal për mënyrën e saktë, profesionale dhe të qartë të mënyrës së paraqitjes së problemeve kryesore dhe përqasjes së propozuar. Kërkojmë një shpjegim se pse nga 30 pikë meritojmë vetëm 25.33 ndërkohë që shoqërinë Gjeokonsult&CO shpk e kemi vlerësuar maksimalisht. Mbi cilat kritere e kemi bërë këtë vlerësim??

- Nënkriteri tjetër i vlerësimit teknik-Kualifikimet e stafit kryesor të propozuar
Sipas kërkesave të DST për këtë projekt kërkohet një listë me stafin kryesor, e inxhinierët e nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponentëve të saj, shoqëruar me CV e tyre, diplomën, kontratën e punës si dhe licencat profesionale për mbikqyrje. Sipas përmbajtjes së listës kërkohet që inxhinierët të kishin eksperiencë sipas fushave që mbulojnë pa përcaktuar se sa vite eksperiencë të përgjithshme dhe sa vite eksperiencë në fushën përkatëse (specifike) duhet të kishte secili.

Mbështetur në këto kërkesa inxhinieri i paraqitur sipas fushave të kërkuara nëse ka CV, diplomën, kontratën e punës dhe licencën personale për mbikqyrje plotëson kushtin për një vlerësim maksimal 50+10 dhe diferenca del nga oferta ekonomike.

Inxhinierët e paraqitur nga BOE IKN & Geosat shpk janë me eksperiencë të përgjithshme dhe specifike shumëvjeçare me kualifikime sipas fushave të tyre me tituj shkencorë cka ben të drejtë kërkesën tonë për një vlerësim maksimal.

Tabela 3 Stafit i propozuar dhe kualifikimet e tyre

<i>Nr</i>	<i>Emer Mbimer</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Kualifikimi i Përgjithshëm</i>	<i>Kualifikimi Specifik</i>
1	A.C	Drejtes projekt Ing Ndërtimi	28 vite	15 vite
2	A..M	Mbikqyrës materialesh Ing Ndërtimi	22 vite	12 vite
3	I.A	Mbikqyrës për punimet e topografisë-Ing Topograf	21 vite	7
4	F.R	Mbikqyrës Gjeolog-Ing Gjeolog	36 vite	13 vite
5	K.Z	Mbikqyrës për punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore-Ing Mekanik	32 vite	14 vite
6	G.L	Mbikqyrës për punimet e rrjetit të ujës-jellës-Ing Hidroteknik	20 vite	4 vite
7	A.H	Mbikqyrës për punimet e gjelbërimit-Ing Mjedis	21 vite	5 vite
8	K.G	Mbikqyrës për punimet elektrike-Ing Elektrik	45 vite	10 vite
9	B.C	Mbikqyrës për veprat e artit-Ing Ndërtimi	Mbi 45 vjet me titull Doktor i Shkencave	27 vite

Përvec listës së stafit kryesor kemi paraqitur edhe listën e stafit mbështetës të cilët janë të lirë të mbështesin stafin kryesor në realizimin me sukses të kësaj kontrate. Si staf teknik

mbështesës janë rreth 22 inxhinierë të specialiteteve të ndryshme shumica e të cilëve janë me kualifikime , me licenca personale me tituj shkencorë sipas fuushave të tyre. Gjithsej BOE IKN&Geosat ka rreth 49 të punësuar , mbi 95% të të cilëve janë inxhinierë me licencë personale.

Ju kujtojmë se me të njëjtat punë të ngjashme dhe staf BOE që ne përfaqësojmë është vlerësuar maksimalisht në procedura të tjera prokurimi ndërsa në këtë procedurë duke mos pasur asnjë arsye për skualifikimin tonë por duke mos dashur të na shpallni fitues për këtë kontratë keni bërë një vendosje krejt subjektive të pikëve.

Ky numër dhe kjo cilësi e stafit tonë është më tepër nga të punësuarit e Gjeokonsult & Co shpk që ka marrë vlerësim maksimal nga ju. Mund të dimë mbi cilin kriter jeni bazuar për vlerësimin tuaj?? A mund të bëjmë një krahasim të kualifikimeve të stafëve të paraqitur nga BOE IKN&Geosat dhe atij të paraqitur nga Gjeokonsult&Co shpk?

II.7. Në datën 14.08.2019, nëpërmjet shkresës me nr.7620/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës me argumentat si më poshtë:

- *Arsyeja e vlerësimit me 9 pikë për punët e ngjashme për propozimin tuaj është e drejtë. Kjo për faktin se kompania e cila ka marrë pikët maksimale ka sjellë si punime të ngjashme më tepër mbikqyrje për objekte të infrastrukturës rrugore se sa kompania juaj. Për më tepër në punime të ngjashme ju keni përfshirë edhe Mbikqyrjen e objektit Mbrojtja dhe sistemi i pjesës së poshtme të digës së Qyrsaqit me vlerë 2,220,700 lekë pa tvsh e cila nuk konsiderohet si punim i ngjashëm.*
- *Lidhur me metodologjinë e propozuar jeni vlerësuar me 25.33 pikë pasi materiali i ofruar bazohet në statistika të përgjithshme mbi metodologjinë. Ndërkohë që operatori tjetër është më bindës në materialin e tij duke paraqitur më shumë detaje.*
- *Lidhur me kualifikimet e stafit kryesor të propozuar në përgjithësi mund të sqarojmë se vite total pune të eksperiencës së stafit të paraqitur të operatorit tjetër janë 403 vite eksperiencë ndërkohë që stafi juaj në total ka 270 vite eksperiencë.*

II.8. Në datën 23.08.2019 operatorit ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 8043/1 prot., datë 29.08.2019, protokolluar me tonën me shkresën nr.1430/2 datë 02.09.2019 , me objekt “*Dërgim informacioni*”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues “Instituti i Konsulencës në Ndërtim IKN” shpk & “Geosat Group” shpk për kundërshtimin e vlerësimit të propozimit teknik të këtij të fundit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në nenin 3, pika 3 e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Kontratat e konsulencës” janë kontratat për shërbime publike konsulence, të një natyre intelektuale dhe këshilluese, duke përjashtuar llojet e tjera të shërbimeve, ku mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë”*.

III.1.2. Në nenin 37 “Shërbimet e konsulencës”, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me fazë, sipas nenit 34/1 të LPP-së, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.*

ii. Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

- Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:
- përvojën e konsulentit; - cilësinë e metodologjisë së propozuar; - kualifikimet e stafit kryesor të propozuar; - transferimin e njohurive, nëse kërkohet. *“Nëse nuk kërkohet, pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t’i shtohen kriterit “kualifikimet e stafit kryesor të propozuar”*.

Çdo kriter vlerësohet në një shkallë nga 1 deri në 100 e, më tej, pesha e tyre kthehet në pikë përkatëse. Minimumi i pikëve të propozimit teknik për të vazhduar me vlerësimin e propozimit ekonomik është 70 pikë. Formula që zbatohet në këtë rast parashikohet në dokumentet standarde të tenderit.

Vlerësimi i propozimeve teknike kryhet brenda 20 (njëzet) ditëve nga afati i përfundimtar i përcaktuar për hapjen e tyre. Ky proces regjistrohet nëpërmjet procesverbalit të mbajtur për këtë qëllim.

“Secili prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave duhet të shpjegojë në detaje vlerësimin e tij”.50

Autoriteti kontraktor vë në dijeni ofertuesit që kanë dorëzuar propozime për çdo vlerësim teknik me pikë për secilin konsulent. Në çdo rast, autoriteti kontraktornjofton ata konsulentë, propozimet e të cilëve nuk kanë arritur të fitojnë pikët minimale ose që janë vlerësuar se nuk i plotësojnë kërkesat për propozim dhe i kthen të pahapura propozimet ekonomike. Në përfundim të afateve të ankimit, autoriteti kontraktor njofton konsulentët që kanë realizuar

pikët minimale kualifikuese për datën, orën dhe adresën për hapjen e propozimeve ekonomike.

III.1.3. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.1. “Autoriteti Kontraktor shqyrton çdo propozim teknik për të konfirmuar nëse ai është në pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në Dokumentat e Tenderit dhe se i pranon të gjitha afatet e kushtet. Propozimi që nuk plotëson Termat e References, ose dështon në pajtueshmërinë e kushteve dhe afateve të kontratës, të shprehura në Dokumentat e Tenderit, do të refuzohet. Autoriteti Kontraktor vlerëson dhe rendit propozimet teknike në pajtim me procedurat dhe kriteret e vlerësimit të paraqitura në Dokumentat e Tenderit. Asnjë kriter vlerësimi nuk do të përdoret, nëse nuk është paraqitur në Dokumentat e Tenderit. Nëse Dokumentat e Tenderit parashikojnë një rezultat minimal që duhet të arrihet, çdo propozim që nuk arrin këtë minimum do të refuzohet.

III.1.4. Në dokumentat e tenderit, kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 5, pika 5.5. “Kriteret e vlerësimit”, janë përcaktuar kriteret e vlerësimit si më poshtë:

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit [0-10]

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitura në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar

[20-30]

Nënkriteret

ii/a. Përfaqsjë teknike dhe metodologjia [20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku u dorëzimit të projektit [30-40%]

ii.c. Organizimi i Stafit [20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me përqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Staf: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [20-50]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

- | | |
|------------------------------------|-----------|
| a- Kualifikim i përgjithshëm | [5-20%] |
| b. Eksperienca në fushën përkatëse | [30-80 %] |

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencë.

- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin:eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e KVO në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(iv) Transferimin e Njohurive, (nëse kërkohet) [0-10]

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atehërë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit “Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar”.

Total (Propozimi Teknik) 100%

- **Minimumi i pikëve të Propozimit Teknik, per te vazhduar me vleresimin e propozimit ekonomik, është 70 pikë.**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe- Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu- Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç – Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.8)$

: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.2)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

$$\text{Oferta më e mirë} = X + Y$$

Operatori ekonomikë që ka marrë më shumë pikë gjatë mbledhjes së pikëve teknike dhe ekonomike do të ftohet për negociata dhe lidhjen e kontratës.

III.1.5. Në shtojcën 10 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.1 dhe 2.3.3 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatorëve ekonomikë i është kërkuar përmbushja e kushteve si më poshtë:

2.3.1 Përvoja e mëparshme:

Kandidati/ofertuesi duhet të ketë realizuar shërbime të ngjashme me objektin që prokurohet, me vlerë jo më të vogël se 38% të fondit limit të kontratës që prokurohet, realizuar me sukses gjatë tri viteve të fundit.

**Kjo të vërtetohet me kopje të kontratave / vërtetim të lëshuar nga një ent publik dhe faturat tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimi i realizuar. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohet, fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara .*

**Si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimit”.*

- 2.3.3 Një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe komponenteve të saj, lista e personelit të përfshihen CV-të e tyre , diplomën, kontratën e punës, si dhe licencat profesionale për mbikqyrje,. Lista e stafit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit, të përmbajë:
- **Drejtuesin e projektit** që duhet të jetë **inxhinier ndërtimi**, me eksperiencë pune në mbikqyrje i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimit të volumeve,
- **Mbikqyresin e materialeve** që duhet të jetë **inxhinier ndërtimi**, me eksperiencë pune në këtë fushë i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.
- **Mbikqyresin për punimet topografike** që duhet të jetë **inxhinier topograf**, me eksperiencë pune i cili kontrollon dhe miraton volumet, piketimet dhe kuotëzimin e objektit.
- **Mbikqyrësin (gjeolog)**, duhet të jetë **inxhinier gjeolog** me eksperiencë pune i cili kontrollon punimet gjatë gërmimit.
- **Mbikqyrësin për punimet e sinjalistikes dhe sigurisë rrugore**, duhet të jetë **inxhinier mekanik, ose inxhinier me licencë për punimet e sinjalistikes rrugore** dhe me eksperiencë pune në këtë fushë. i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton cilësinë e punimeve.

- **Mbikqyrësin për punimet e rrjetit të ujesjellesit** që duhet të jetë **inxhinier hidroteknik**, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.
- **Mbikqyrësin për punimet e gjelberimit** që duhet të jetë **inxhinier mjedisi ose arkitekt**, me licence dhe eksperiencë pune në këtë fushë.
- **Mbikqyrësin për punimet elektrike** duhet të jetë **inxhinier elektrik**, me licence dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.
- **Mbikqyrësin për veprat e artit** që duhet të jetë **inxhinier konstruktor** me eksperiencë pune në projektim dhe në zbatim me licensë për këtë qëllim.

***Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.**

III.1.6. Referuar bazës ligjore të sipërcituar që disjeron shërbimin e konsulencës, ku parashikohet se në tërësi propozimi teknik i nënshtrohet vlerësimit të tre elementëve kryesorë, të tillë si përvoja e konsulentit, kualifikimi i stafit të propozuar si dhe metodologjia e propozuar nga operatorët ekonomikë të kualifikuar në fazën e parë të procedurës, si dhe duke pasur parasysh të gjitha kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik në analizë të projekteve teknike të dorëzuar në këtë procedurë prokurimi, konstaton se në lidhje me eksperiencat e mëparshme BOE ankimues Instituti i Konsulencës në Ndërtim IKN” shpk& “Geosat Group” shpk, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

N r	Kontrata	Subje kti	Viti i përfundi mit	Investit ori	Pjesm arrja në përqin dje	Vlera e kontratës pa tvsh	Vlera pa tvsh	Përshkrimi i shkurtër i punimeve të superviizuara
1	Ndërtim i infrastruk turës rrugore në kompleksi n Hamallaj	IKN	Prill 2018	Mane TCI	100%	2,880,000	2,880,000	Supervizim i infrastrukturës rrugore të rrugës hyrëse dhe të brendshme të kompleksit me të gjithë elementët e saj
2	Mbrojtja dhe sistemi i pjesës së	IKN	Gusht 2018	KESH	70 %	3,172,432	2,220,702	Supervizim i punimeve të ndërtimit i cili ka konsistuar me

	<i>poshtme të digës së Qyrsaqit</i>							<i>gërmime në prezencë të ujit, ndërtim pilotash, sistemim dhe mbrojtje skrapatash dhe ndërtim murresh me gabion</i>
3	<i>Rikualifikim i shatërvanit tek Zogu Zi</i>	<i>IKN</i>	<i>Tetor 2018</i>	<i>Fushë Krujë Cement Factory /përfitues Bashkia Tiranë</i>	<i>100%</i>	<i>2,307,060</i>	<i>2,307,060</i>	<i>Supervizim i punimeve konsiston në punime ndërtimi si: gërmime, betonime, hekur betoni, hidroizolime etj, instalime mekanike si instalim i gjithë tubacioneve dhe rakorderive , pompave e filtrave të shatërvanit, instalimet elektrike të paneleve përkatëse si dhe mbjellje të pemëve e shkurreve dhe sistemin automatik të vaditjes së tyre.</i>
4	<i>Ndërtim Rrugor Porto Romano Loti I</i>	<i>Geosat</i>	<i>Shtator 2017</i>	<i>ARRSH</i>	<i>100%</i>	<i>4,900,452</i>	<i>4,900,452</i>	<i>Ndërtim i rrugës në trase plotësisht të re me të gjithë elementët e saj , nga gërmimi , strukturat e betonit, shtresat</i>

								<i>rrugore, sinjalistike etj</i>
5	<i>Supervizi m i rikonstru ksionit të rrugës rrethrot ullimi i doganës — mbikalimi kashar dhe rikonstru ksioni i rrugës hyrëse të Elabasan it segmenti Fakulteti Filologjik Unaza e Madhe</i>	<i>Geos at</i>	<i>Shtator 2015</i>	<i>FSHZH</i>	<i>80%</i>	<i>2,900,000</i>	<i>2,320,000</i>	<i>Supervizim i punimeve rrugore me të gjithë infrastrukturën nëntokësore, shtresave asfaltike, punimet e sistemimit dhe gjelbërimit</i>
6	<i>Rikualifik imi Urban i Sheshit Skënderb ej</i>	<i>Geos at</i>	<i>Nëntor 2017</i>	<i>Bashkia Tiranë</i>	<i>40%</i>	<i>3,788,600</i>	<i>1,515,440</i>	<i>Supervizim i punimeve të infrastrukturës nëntokësore, punimet e betonit, ndërtim i sheshit dhe infrastruktrës rrugore përreth si dhe sistemimi i sheshit</i>

- Kontratë Nr.771 rep nr.386 Kol datë 31.05.2019 “Bashkimi i përkohshëm i shoqërive lidhur ndërmjet IKN&Gesoat Group shpk” për objektin “Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2”.IKN do të kryejë mbikqyrjen për të gjitha punimet që përfshihen në kategori të tilla si:

Ndjekje e projektit nga ana konstruktive e tij, ndjekjen e punimeve nga ana elektrike, ndjekjen e punimeve nga ana gjeologjike, punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore, punimet topografike, për punimet e rrjetit të ujësjellësit , veprave të artit etj dhe Shoqëria Gesoat Group shpk do të marrë pjesë në mbikqyrjen për punimet e gjelbërimit dhe të mjedisit për punimet topografike, punimet hidroteknike, konstruktive në objektin e sipërcituar.

- *Marrëveshje shërbimi mes paleve Mane TCI shpk dhe IKN shpk datë 08.04.2015 me objekt Mbikqyrje Punimesh për objektin Ndërtim i infrastrukturës rrugore në kompleksin Hamallaj, me vlerë 2,880,000 lekë pa tvsh, shoqëruar me vërtetim lëshuar nga Mane TCI shpk (Vlera e shërbimit të mbikqyrjes është 2,880,000 lekë pa tvsh për periudhën 36 muaj nga 08.04.2015-08.04.2018), Fatura Tatimore Shitje.*
- *Kontratë Nr.313/11 datë 04.04.2017 me objekt Mbikqyrja e punimeve për mbrojtjen dhe sistemimin e pjesës së poshtme të digës së Qyrsaqit në HEC VAU DEJËS me palë kontraktore KESH sha dhe BOE IKN&Eraldi G, me vlerë të kontratës 3,806,918.4 lekë me tvsh, Vërtetim Realizimi Nr.5372/1 datë 07.11.2017, Formular Vlerësimi nr.5647 prot datë 14.11.2017 (70% IKN dhe 30% Eraldi G), Certifikatë përfundimtare e marrjes në dorëzim të punimeve Nr.4509 prot datë 14.08.2018, Procesverbal Kolaudimi, Fatura Tatimore Shitje.*
- *Marrëveshje Shërbimi datë 08.11.2017 lidhur ndërmjet Fushë Krujë Cement Factory shpk dhe IKN me objekt Mbikqyrje punimesh për objektin “Rikualifikim i shatërvanit tek Zogu Zi” , Fatura Tatimore Shitje me vlerë 2,307,060.*
- *Kontratë Mbikqyrje Punimesh nr.10353/7 datë 31.12.2008 në objektin “Ndërtim rruga Porto Romano Loti I lidhur ndërmjet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Geosat Group shpk me vlerë të kontratës 5,880,542 lekë me tvsh, Referencë për shërbim konsulence Nr.8896 prot datë 12.10.2018 për shoqërinë Geosat shpk, Formular Vlerësimi (Data e fillimit të kontratës 30.12.2008-Data e përfundimit të punimeve 29.12.2016, Data e Kolaudimit të objektit 07.09.2017, vlera e situacionit përfundimtar 5,880,542 me tvsh), Procesverbal Kolaudimi Nr.7230 prot datë 14.09.2017*
- *Kontratë Shërbimi lidhur ndërmjet FSHZH dhe BOE Geosat Group& Atelier 4& Infratech shpk me objekt Supervizion i punimeve të rrugëve Rikonstruksion i rrugës Rrethrrrotullimi i Doganës-Mbi kalimi Kashar dhe Rikonstruksioni i rrugës Fakulteti Filologjik-Unaza e Madhe Tiranë e lidhur më __.10.2014, me vlerë 2,900,000 lekë pa tvsh, Amendim kontratem Kontratë Bashkepunimi Geosat&Infratech&Atelier 4 datë 22.08.2014 në raportet 80% për Gesoat Group, 10% për Atelier Group dhe 10% për Infratech shpk. Vërtetim Punimesh Nr.1121/2 prot datë 16.08.2016 lëshuar nga FSHZH për shoqërinë Geosat shpk i cili ka realizuar kontratën e shërbimit të konsulencës me afat zbatimi Tetor 2014-Nëntor 2015 me vlerë 3,480,000 lekë me tvsh me objekt supervizionin për segmentet rrugore: Rikonstruksion i rrugës Rrethrrrotullimi i Doganës-Mbi kalimi Kashar me vlerë 275,270,827 lekë me tvsh dhe Rikonstruksioni i rrugës Fakulteti*

Filologjik-Unaza e Madhe Tiranë me vlerë investimi 154,323,721 lekë me tvsh, Fatura Tatimore Shitje 09.11.2015-dhe 20.09.2017.

- *Kontratë Nr.2459/6 prot datë 06.09.2016 me objekt Mbikqyrje Punimesh për objektin Rikualifikim Urban i Sheshit Skënderbej Faza I lidhur ndërmjet Bashkia Tiranë dhe BOE 51N4E degë e shoqërisë së huaj %Geosat Group në masën 60% 51N4E dhe 40% Gesoat Group shpk, me vlerë të kontratës 4,546,320 lekë me tvsh., Kontratë bashkëpunimi 60% 51N4E dhe 40% Gesoat Group shpk.*

III.1.7. Nisur nga sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, referuar objektit të prokurimit, BOE ankimues “IKN” shpk & “Geosat Group” shpk, në veprimtarinë e tyre, shfaqin një eksperiencë të gjërë në fushën e mbikqyrjes/supervizimit, duke vërtetuar se kanë kryer shërbime të njëjta me objektin e prokurimit. Në këto kushte, referuar nenit 37 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me dokumentacionin e paraqitur, nga BOE IKN shpk & “Geosat Group” shpk vërtetohet se, bashkimi i operatorëve ekonomik, bashkarisht plotësojnë kushtin për realizimin e kontratave të ngjashme (në rastin konkretë janë të njëjta) me objektin e prokurimit, e si rrjedhim pretendimi i këtij bashkimi operatorësh ekonomik për një vlerësim maksimal të përcaktuar për këtë kriter, është tërësisht i bazuar. Komisioni, gjykon se, procesi i pikëzimit në procedurat e konsulencës, duhet të bëhet në përputhje dhe në proporcion me dokumentacionin e paraqitur nga secili ofertues, i cili, nga ana tjetër, duhet të jetë sa më afër kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. Fryma e ligjit të prokurimit publik, është e tillë që, çdo operator duhet të përgatisë ofertën e tij në përputhje me kriteret dhe kërkesat e parashikuara në dokumentat e tenderit. Në rastin konkret, kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për “Përvoja për punë të ngjashme” në fushën e projektimit, është plotësuar më së miri nga ky bashkim operatorësh ekonomik. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë, të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por nga ana tjetër ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime jo maksimale, në kushtet kur, dukshëm, operatori ekonomik provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion të plotë e të mjaftueshëm për t’u vlerësuar me pikët maksimale.

Sa më sipër pretendimet e BOE ankimues qëndrojnë.

III.2. Lidhur me stafin kryesor të propozuar rezulton se nga ana e BOE ankimues është paraqitur dokumentacioni si më poshtë vijon:

Lista e personelit Kryesor

<i>Nr</i>	<i>Emer Mbimer</i>	<i>Pozicioni</i>	<i>Kualifikimi i Përgjithshëm</i>	<i>Kualifikimi Specifik</i>
-----------	--------------------	------------------	-----------------------------------	-----------------------------

1	A.C	Drejtues projekti Ing Ndërtimi	28 vite	15 vite
2	A.M	Mbikqyrës materialesh Ing Ndërtimi	22 vite	12 vite
3	I.A	Mbikqyrës për punimet e topografisë-Ing Topograf	21 vite	7
4	F.R	Mbikqyrës Gjeolog-Ing Gjeolog	36 vite	13 vite
5	K.Z	Mbikqyrës për punimet e sinjalistikës dhe sigurisë rrugore-Ing Mekanik	32 vite	14 vite
6	G.L	Mbikqyrës për punimet e rrjetit të ujës-jellës-Ing Hidroteknik	20 vite	4 vite
7	A.H	Mbikqyrës për punimet e gjelbërimit-Ing Mjedisi	21 vite	5 vite
8	K.G	Mbikqyrës për punimet elektrike-Ing Elektrik	45 vite	10 vite
9	B.C	Mbikqyrës për veprat e artit- Ing Ndërtimi	Mbi 45 vjet me titull Doktor i Shkencave	27 vite

1. CV A.Z Eksperienca profesionale Nga 1994-2017 e në vazhdim , Diplomë Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me titull Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale lëshuar më 29.06.1991, Kontratë Pune datë 01.06.2019 lidhur ndërmjet IKN dhe A.Z me detyrë Drejtues Teknik në Projektim, Licencë MK.3053/2 Për Mbikqyrje dhe

Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 13.12.2018 A.Z, Licencë K.0510/6 në Projektim datë 13.12.2018

- 2. CV A.M Mbikqyrës Materialesh, Eksperienca Profesionale nga 1999-2017 e në vazhdim, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit datë 19.09.1997 i jepet titulli Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale, Kontratë Pune datë 01.06.2019 lidhur ndërmjet IKN dhe A.M në detyrën Drejtues Teknik në Projektim, Licencë MK.3149 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 22.01.2018, Certifikatë lëshuar nga Kolegji Harry Fultz Kursi Autocad 2D, Dëshmi lëshuar nga Albanian Geotechnical Society cila vërteton se A.M ka marrë pjesë në seminarin ndërkombëtar me temë Projektim, ndërtim, monitorimi, mirëmbajtja e veprave inxhinierike....*
- 3. CV I.A Mbikqyrës për Punimet e Topografisë Eksperienca Profesionale 2009-2017 e në vijim, Diplomë Ismet Alla lëshuar nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave të UPT në degën Markshajderi me titull Inxhinier Miniere me orientim Markshajderi datë 23.07.1998, Kontratë Pune datë 30.09.2017 lidhur ndërmjet Geosat Group shpk dhe Ismet Alla me detyrë Inxhinier Topograf, Licencë MK.2349 Për Mbikqyrje e Kolaudim Punimesh Zbatimi datë 17.09.2012*
- 4. CV-F.R-Mbikqyrës Gjeolog, Eksperienca profesionale 1983-2018 e në vijim, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Gjeologjisë dhe Minierave në degën e Gjeologjisë me titull Inxhinier Gjeolog, Kontratë Pune Individuale datë 30.07.2018 lidhur ndërmjet IKN dhe Ferit Roci me detyrë Drejtues Teknik për projektim punimesh të Inxhinierisë Gjeologjike, Licencë MK.2113/1 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 11.09.2018, Licencë Gj.0539/1 Në Projektim .*
- 5. CV K.Z-Mbikqyrës për Punimet e Sinjalistikës dhe Sigurisë Rrugore, Eksperienca Profesionale 1988-Qershor 2017 e në vazhdim, Diplomë datë 14.01.1987 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Elektrike në degën Mekanike me titull Inxhinier Mekanik për Industrinë, Diplomë datë 26.10.2007 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike i jepet titulli Inxhinier Mekanik Drejtimi Mjete Tokësore, Licencë MK.3078/1 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 25.10.2018, Licencë M.1281/1 në Projektim datë 25.10.2018, Certifikatë Aftësie për Auditues/Inspektues të Sigurisë Rrugore, Kontratë Pune datë 12.06.2017 lidhur ndërmjet IKN dhe K.Z me detyrë Drejtues Teknik Ing Mekanik drejtimi Mjete Tokësore*
- 6. CV G.L –Mbikqyrës për punimet e rrjetit të Ujësjellësit, Eksperienca Profesionale 2011-2017, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në degën Hidroteknike datë 16.10.1999 ne titull Inxhinier Hidroteknik, Kontratë Pune datë 29.09.2017 lidhur ndërmjet Geosat Group shpk dhe G.L në detyrën Ing. Hidroteknik, Licencë MK.2747 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 06.11.2015*

7. CV A.H-Mbikqyrës për Punimet e Gjellbërimit, Eksperienca Profesionale 1998-2017 e në vijim, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit në degën Mjedis datë 17.07.1998 me titull Inxhinier Mjedis për Energjitik, Licencë MK.3135 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 19.12.2017, Kontratë Pune dtaë 05.12.2017 lidhur ndërmjet Geosat Group dhe A.H me detyrë Inxhinier Mjedis, Certifikatë Nr.11627 prot datë 10.12.2014 për “Hartimin e raporteve të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.
8. CV K.G –Mbikqyrës për Punimet Elektrike , Eksperienca profesionale 1973-2018 e në vazhdim, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë në degën Elektrike datë 30.06.1973 me titull Ing Elektrik, Licencë MK.2127/1 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 30.03.2017, Licencë E.0385/4 në Projektim datë 11.09.2018, Kontratë Pune dtaë 27.07.2018 lidhur ndërmjet IKN dhe K.G me detyrë Drejtues Teknik për projektim punimesh të Inxhinierisë elektrike.
9. CV B.C –Mbikqyrës për Veprat e Artit, Eksperienca Profesionale 1961-2017 e në vijim, Diplomë lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë datë 29.06.1961 me titull Inxhinier Ndërtimi, Certifikata Gradë Shkencore Kandidat i Shkencave Komisioni i Lartë i Atësimit, RPSH Kandidat i Shkencave, Titulli Shkencor Docent, Certifikata Mirënjohje UPT, Certifikatë nga Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë, Vërtetim Komisioni i Kualifikimit Shkencor Doktor i Shkencave, Licencë MK.0897/2 Për Mbikqyrje dhe Kolaudim të Punimeve të Zbatimit datë 29.05.2017, Licencë K.0151/5 Në Projektim datë 29.05.2017 , Kontratë Pune dtaë 25.01.2016 lidhur ndërmjet IKN dhe B.C me detyrë Drejtues Teknik.

Lista e Stafit Mbështetës

Nr.	Profesioni	Numri
1	Inxhinier Ndërtimi	5
2	Inxhinier Elektronik	2
3	Inxhinier Topograf	2
4	Inxhinier Gjeolog	1
5	Inxhnier Mjedis	2
6	Inxhinier Përpun Druri	1

7	<i>Inxhinier Elektrik</i>	1
8	<i>Arkitekt</i>	2
9	<i>Inxhinier Hidroteknik</i>	2
10	<i>Ekonomiste/Juriste</i>	4

III.2.1. Lidhur me pretendimin e BOE ankimues mbi vlerësimin me pikë për stafin kryesor të propozuar, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, është paraqitur dokumentacion në lidhje me stafin e nevojshëm të kërkuar në dokumentat e tenderit, atë kryesor dhe mbështetës, për të gjitha specialitetet dhe profilet e kërkuara duke u shoqëruar me licencat profesionale në projektim, CV-të, kontratat e punës, diplomat, dokumentacion ky i paraqitur sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit, nëpërmjet të cilave evidentohen qartë profesionet, kualifikimet, profilet e punës, dhe eksperiencat e mëparshme të realizuara prej tyre. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nisur nga dokumentacioni i BOE ankimues, ku evidentohet se plotësohen dhe tejkalohen dukshëm kërkesat e autoritetit kontraktor i cili në rastin konkret nuk ka vendosur kufizime lidhur me eksperiencën e punonjësve, si edhe nga verifikimi i licencave, cv, diplomave, kualifikimeve etj., autoriteti kontraktor duhej të pasqyronte vlerësimin me pikë jo minimalisht për këtë bashkim operatorësh ekonomik në lidhje me stafin e tij. Pretendimi i ankimuesit për vlerësimin maksimale, është i bazuar për sa kohë që gjatë shqyrtimit të dokumentacionit nuk është evidentuar asnjë mangësi apo parregullsi, të cilat do të ndikonin në uljen e vlerësimit me pikë për këtë kriter. Një gjykim tërësisht subjektiv dhe të paarsyeshëm ka mbajtur edhe KSHA gjatë shqyrtimit të ankesës së BOE ankimues duke argumentuar se *lidhur me kualifikimet e stafit kryesor të propozuar në përgjithësi mund të sqarojmë se vite total pune të eksperiencës së stafit të paraqitur të operatorit tjetër janë 403 vite eksperiencë ndërkohë që stafi juaj në total ka 270 vite eksperiencë*. KPP gjykon se një gjykim i tillë sipërfaqësor dëshmon se KSHA nuk ka analizuar në thellësi përvojat profesionale të secilit punonjës pjesë e stafit të BOE ankimues të cilët rezultojnë të gjithë brenda profilit të kërkuar dhe me eksperiencë të konsiderueshme.

Akoma më tej në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, autoriteti kontraktor nuk ka kërkuar asnjë minimum eksperience për asnjë punonjës ndërkohë eksperiencat e prezantuara të punonjësve të stafit të BOE dëshmojnë për përvojë të gjatë profesionale. KPP gjykon se BOE ankimues e plotëson dhe tejkalon bindshëm kriterin e vecantë të kualifikimit duke merituar maksimumin e pikëve lidhur me kualifikimin e përgjithshëm, kjo duke marrë në konsideratë edhe kualifikimet profesionale.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Komisioni sqaron autoritetin kontraktor, se, vlerësimi është i matshëm në kushtet kur, niveli i pikëzimit është në raport me dokumentacionin e paraqitur, pra vlerësimi me pikë jepet duke analizuar dokumentacionin e paraqitur në lidhje me stafin, duke përfshirë shumë elementë të tillë si numri i personelit, eksperiencia, profesionet, vitet e punës pranë shoqërisë ankimuese, etj. Komisioni gjykon se vlerësimi dhe gjykimi i komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime me ndryshime të dukshme e të thella, në kushtet kur, dukshëm operatori ekonomik provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion të mjaftueshëm për t'u mos u vlerësuar me pikët minimale.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

III.3..Në lidhje me metodologjinë e propozuar, BOE ankimues ka dorëzuar metodologjinë përkatëse (244 fletë) në të cilën jepet një përshkrim i përjasjes teknike, metodologjisë së realizimit të punimeve, referencat teknike, objektivat, , planin e punës dhe grafikun e detajuar të realizimit të shërbimit. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, është e vërtetë se, vlerësimi me pikë bazohet në gjykimin personal dhe individual të secilit prej anëtarëve të komisionit të vlerësimit të ofertave, brenda diapazonit me pikë të përcaktuar në dokumentat e tenderit, por, nga ana tjetër, ky vlerësim dhe gjykim, nuk duhet të jetë subjektiv, por i bazuar dhe arsyetuar mbi dokumentacionin e paraqitur nga secili operator ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke mos dhënë vlerësime minimale, në kushtet kur, dukshëm BOE provon dhe vërteton se ka paraqitur një dokumentacion ku nuk meriton për t'u vlerësuar me pikët minimale, sidomos lidhur me planin e punës dhe grafikut të dorëzimit të projektit. Një gjykim subjektiv dhe sipërfaqësor ka mbajtur edhe KSHA gjatë trajtimit të ankesës së BOE ankimues duke cituar se *lidhur me metodologjinë e propozuar jeni vlerësuar me 25.33 pikë pasi materiali i ofruar bazohet në statistika të përgjithshme mbi metodologjinë. Ndërkohë që operatori tjetër është më bindës në materialin e tij duke paraqitur më shumë detaje.* Me këtë argument KSHA nuk ka evidentuar asnjë mangësi të metodologjisë së prezantuar por ka përdorur terma abstraktë se operatori tjetër ka paraqitur më shumë detaje pa ju referuar asnjë detaji i cili mungon në metodologjinë e BOE ankimues.

BOE ankimues, në metodologjinë e paraqitur, ka përshkruar të gjitha pikat e përcaktuara ne termat e referencës të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, në mënyrën që ky i fundit ka gjykuar se janë më të përputhshme dhe më të mira për realizimin e objektit të prokurimit. Metodologjitë apo përjasjet teknike të ofruara, të cilat nuk janë pikë për pikë sipas pritshmërive të komisionit të vlerësimit të ofertave, nuk mund të përbëjnë shkak për penalizim të operatorëve duke i vlerësuar me pikët minimale, pasi legjilacioni parashikon një diapazon nga 20 deri në 30 pikë lidhur me metodologjinë. Komisioni i Prokurimit Publik

gjykon se autoriteti kontraktor duhet të rivlerësojë vlerësimet me pikë lidhur me metodologjinë e propozuar.

Sa më sipër, pretendimi i BOE ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e BOE “IKN” sh.p.k & “Geosat” shpk për procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr.REF-23485-05-23-2019, me objekt “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 2*”, me fond limit 10.700.000 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 12.07.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë rivlerësimin e procedurës së mësipërme në zbatim të konstatimeve të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga BOE “IKN” sh.p.k & “Geosat” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1430 protokolli Datë 23.08.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha

